



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E SKENDERAJ
DIREKTORIA PËR BUIQËSI PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Nr. 10-3.161-0017804/25
Data 15.05.2025

Republika e Kosovës

Komuna Skenderaj

Islamic Relief Kosova

Republika Kosovo

Opština Skenderaj

Republic of Kosovo

Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural

Direkcija za Poljoprivredu Šumarstvo i Ruralni Razvoj

Department of Agriculture Forestry and Rural Development

DATE/A:	15.05.2025
PËR/ZA/TO	Për Fëmijët e Komunës së Skenderajt
Njoftim	Zyrës së Kryetarit të Komunës Skenderaj z. Fadil Nura
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural Behxhet Malit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Thirrje për Aplikim për subvencionim për pajisje bujqësore dhe sera

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në bashkëpunim me organizatën Islamic Relief Kosova (IRK), hapë thirrjen e aplikimit për subvencionim me pajisje bujqësore dhe sera për mbështetjen e qëndrueshme të jetës në zonat rurale.

Subvencionimin me pajisje bujqësore dhe sera përfshinë:

- Serë 100 m²,
- Mbjellëse gruri,
- Mbjellëse misri,
- Rota Kosa 135,
- Mbjellëse të patateve dy rendore,
- Freza 1.65 m,

- Spërkatese 400 L,
- Pijatore 24 disqe,
- Pllugi 2 rende,
- Shpërndarëse plehu 500 L,
- Atomizer 400 L,

○ **Kushtet e aplikimit për subvencionim të pajisjeve bujqësore janë:**

1. Te këtë mundësi financiare (participim 20 % e vlerës së projektit), disponojë hapësirë në fermë për realizimin e projekteve të cilat kanë të bëjnë me kulturat ndryshme.
2. Fermerët të cilët kanë përfituar grante në vitin 2024 nga DBPZHR dhe donatorët nuk kanë të drejtë aplikim (përfshirë të puseve për ujë të pijes) gjithashtu prioriteti di t'iu kushtohet fermerëve të cilët nuk kanë marrë grante nga MBPZHR.
3. Aplikuesit për mbjellëse misri dhe gruri duhet të kenë të mbjellë këto dy kultura në vitin 2025 dhe të dëshmojnë përmes aplikimeve për subvencione (**përmes aplikimit ju lejohet komisionit të kontrolloj aplikimin në REF**) dhe të planifikojnë mbjelljen e këtyre kulturave edhe për vitet në vazhdim.
4. Përparesi kanë familjet me fëmijë jetim dhe të cilët i plotësojnë kriteret e përgjithshme.
 - **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:**
 1. Çertifikata e bashkësisë familjare,
 2. Numri identifikues i fermerit (NIF),
 3. Letërnjoftimi kopje,
 - Dokumente shpesh në rast se aplikuesi ka fëmijë me aftësi të kufizuara, është invalid i luftës apo familje e dëshmorit kopja e kartonit të ndihmave sociale,
 - Aplikacionet e pakompletuar dhe dokumentacioni nuk do të trajtohen nga komisioni.

Vërejtje: Aplikantët kanë të drejtë të aplikojnë për dy pajisje (ose një pajisje dhe serë) por mund të përfitojnë vetëm njërin prej tyre.

Afati i aplikimit fillon nga data 15.05.2025 deri 30.05.2025 ora 16:00.